

VENDIM
Nr. 158, datë 17.7.2025

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 94, DATË 28.4.2025
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SOLAR HORIZON’ SHPK NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET PRODHUES 2 mw”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 1329/13 prot., datë 9.7.2025 “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.4.2025 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Solar Horizon’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw””,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Solar Horizon” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 94, datë 28.4.2025, ka licencuar shoqërinë “Solar Horizon” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 mw, i ndodhur në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

- Në dispozitivin e këtij vendimi, ERE ka vendosur: *2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.6.2025. 3. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e fillimit të operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës dhe të përditësojë informacionin mbi strukturën organizative të saj, e cila duhet të përmbajë stafin teknik sipas veprimtarisë së licencuar. 4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.*

2. Kërkesa e shoqërisë dhe dokumentacioni i depozituar

- Shoqëria “Solar Horizon” sh.p.k., me shkresën e datës 30.6.2025, protokolluar në ERE me nr. 1329/12 prot., ka paraqitur kërkesë për shtyrjen e afatit të përcaktuar për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë, duke argumentuar se janë në përfundim të punimeve, por kërkojnë hapa të tjerë ligjorë dhe teknikë për kolaudimin dhe vënien në punë të veprës, përfshirë certifikimin nga AKBN-ja, lidhjen e kontratës me FTL, si parakusht 30 ditë para operimit, regjistrimin në treg apo procedura të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

- Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se leja e ndërtimit e dhënë me vendimin nr. 25, datë 2.4.2024, e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT) dhe kontrata e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 2427 rep., nr. 1572 kol., datë 28.4.2023, parashikojnë një afat zbatimi deri më 5.11.2025.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në funksion të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Solar Horizon” sh.p.k., lidhur me shtyrjen e afatit të përcaktuar për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, vlerësohet se:

- kushti i përcaktuar në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.4.2025, është vendosur mbi bazën e deklarimit të bërë nga vetë shoqëria në dokumentacionin e aplikimit për licencim, konkretisht në shtojcën 2 të tij, dhe nuk rrjedh si kufizim i parashikuar në aktet e tjera rregullatore apo kontraktuale;

- sipas lejes së ndërtimit të lëshuar me vendimin nr. 25, datë 2.4.2024 të KKT-së të zbardhur me nr. 395/10, datë 6.11.2024, me objekt “Ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 *mw* dhe veprave ndihmëse”, shoqërisë i është dhënë një afat zbatimi 12-mujor, i cili përfundon më datë 5.11.2025.

- gjithashtu, në nenin 9, pika 2, të kontratës së lidhur ndërmjet shoqërisë dhe MIE-s me nr. 2427 rep., nr. 1572 kol., datë 28.4.2023, është përcaktuar se mbajtësi i miratimit për ndërtim angazhohet të vërë në punë centralin fotovoltaike brenda një periudhe 12-mujore nga data e marrjes së të gjitha lejeve të nevojshme për fillimin e punimeve, në përputhje me grafikun e punimeve të miratuar dhe të bashkëlidhur kontratës.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në funksion të sa parashtruar më sipër, rezulton se afati aktual i përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 94/2025 është më i ngushtë sesa afatet në lejen e ndërtimit dhe kontratën me MIE-n, dhe për këtë arsye, përputhja e tij me këto akte vlerësohet e arsyeshme.

- Bazuar në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, me një akt të ri me shkrim, vlerësojmë që pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.4.2025, duhet të ndryshohet, me qëllim përafrimin e afatit të fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar me afatet e përcaktuara në lejen e ndërtimit dhe kontratën përkatëse me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të cilat parashikojnë përfundimin e projektit brenda datës 5.11.2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.4.2025, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 5.11.2025.”

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Solar Horizon” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, FTL sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti